



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery		05-05-2021	1	viti god. year
Organ /Ijesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSTAK	2188/2021		119	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.266/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.1827/18 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rushqyrtuar ankesën me numër A.nr.257/2018 të datës 03.05.2018 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rr. "Lezhës", VIII/4 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 1107 të datës 04.04.2018 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesa me numër A.nr.257/2018 e datës 03.05.2018 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ministria e Administratës Publike, më datë 25.09.2017 ka shpallur konkursin për pozitën "Udhëheqës Ekzekutiv në Sekretariatit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë", në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila nga Komisioni për Vlerësimin e Kriterëve është përzgjedhur në listën e shkurtër dhe është ftuar në testin me gojë por që nuk ka marr pikët e nevojshme për t'u rekomanduar për emërim. E pakënaqur me Njoftimin për kandidatët më të suksesshëm të datës 14.11.2017, më datë 20.11.2017 ka parashtruar ankesë me Nr. 3409 në Komisionin për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese në Ministrinë e Administratës Publike.

Komisioni për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese në Ministrinë e Administratës Publike më datë 27.11.2017 ka nxjerr Vendim me Nr. 3484 me të cili ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 3484 të datës 27.11.2017 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrinë e Administratës Publike, me datë 18.12.2017 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6613/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke u bazuar në kërkesën e Kryetares së Kolegjit për shqyrtimin e ankesave të datës 12.02.2018 e cila ka kërkuar që afati për vendosje të ankesës të shtohet edhe për 30 ditë, më datë 12.02.2018 ka nxjerr Vendim me numër VK.nr.8/2018 me të cilin ka vazhduar afatin për vendosjen e ankesës së ankueses edhe për 30 ditë të tjera.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.03.2018 ka nxjerr Vendim me numër A/02/796/2017 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr. 3484 të datës 27.11.2017 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrinë e Administratës Publike duke e obliguar të njëjtin për të rishqyrtuar ankesën e ankueses.

Komisioni për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrinë e Administratës Publike, më datë 04.04.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 1107 me të cilin ka refuzuar ankesën e datës 20.11.2017 të parashtruar nga ankuesja.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 1107 të datës 04.04.2018 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrinë e Administratës Publike, me datë 03.05.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2430/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, kundër vendimit të Këshillit ka hapur konflikt administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1827/18 me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e tyre dhe është anuluar vendimi i Këshillit dhe çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2430/2018 e datës 03.05.2018 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 1107 të datës 04.04.2018 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrinë e Administratës Publike; Vendimin me numër A/02/796/2017 të datës 15.03.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokoli 6613/2017 e datës 18.12.2017 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. 3484 të datës

27.11.2017 të Komisionit për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike; Konkursin e datës 25.09.2017 për pozitën "Udhëheqës Ekzekutiv në Sekretariatën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë"; Njoftimin për kandidatët më të suksesshëm; Ankesën e datës 20.11.2017 e parashtruar nga ankuesja në Komisionin për Ankesa për Pozita të Larta Drejtuese të Ministrisë së Administratës Publike; CV-në e ankueses; Certifikatën e datës 30.04.2009 të ankueses; Certifikatën 17.09-29.10.2010 të ankueses; Certifikatën e datës 08.06.1990 e ankueses; Shqyrtimi i gjendjes në IKMMK datës 08.11.2007; Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut e përfaqësuar nga Ambasada Britanike; Kërkesën e datës 12.02.2108; Vendimin me numër VK.nr.8/2018 të datës 12.02.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar në këtë pozitë; Raporti i Komisionit për vlerësimin e Kritereve datës 10.11.2017; Lista e Ngushtë përfundimtare datë 07.11.2017; Formulari Form. MAP-SHCK-09 për Përmbledhjen e vlerësimeve individuale dhe Përgjigjen në ankesë e datës 02.02.2018 me numër protokoll 536/2018; Aktgjykimin A.nr.1827/18 të datës 24.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Përgjigje në padi e datës 10.06.2020; Përgjigje në kërkesë e datës 18.09.2018 dhe 27.07.2018 nga Këshillin për Njoftimin lidhur me moszbatimin e vendimit të Këshillit i datës 03.09.2018; Kërkesën për rishqyrtim të vendimi e datës 06.07.2018; Formular i deklarimit vjetor dhe pagës për tatimin në të ardhura të korporatave; Deklarata e të hyrave dhe shpenzimeve sipas aktiviteteve datë 25.02.2016; Formular i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave; Letër konfirmimin e datës 01.03.2016; Vendimin me Nr. Prot:02/18 i datës 29.01.2018 i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses është bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar që emërimi i Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë në bazë të Vendimit me Nr. Prot:02/18 të datës 29.01.2018 nga Bordi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë është bërë më datë 29.01.2018 me mandat tre (3) vjeçar.

Bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pozita Udhëheqës Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë është pozitë e nivelit të lartë drejtues e cila rekrutohet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës respektivisht nenit 15 dhe dispozitave të Rregullores Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe mandati për pozita të larta drejtuese në bazë të këtij ligji ka qenë tri (3).



Meqenëse mandati për pozita të larta drejtues sipas Ligjtë Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka qenë tre vjeçar, atëherë sipas Vendimit me Nr. Prot:02/18 të datës 29.01.2018, mandati Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i ka kaluar më datë 29.01.2021, rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këto rrethana dhe pas rishqyrtimit të rastit sipas Aktgjykimit A.nr.1827/18 të datës 24.03.2021 të Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar se meqenëse mandati Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i ka kaluar më datë 29.01.2021 rrjedhimisht para se gjykata të vendos për rastin, atëherë, konsiderojmë që objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.266/2021.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Kryetarit të Bordit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
- Menaxherit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.